

RELACION

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN 2005 TË KONVENTËS
PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR
SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR, ADERUAR
ME LIGJIN NR.8850/2001, DHE PROTOKOLLIN 2005
TË PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E AKTEVE
TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE
FIKSE NË SHELFIN KONTINENTAL, ADERUAR
ME LIGJIN NR.8850/2001”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8850, datë 27.12.2001, në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse, të vendosura në Shelfin Kontinental, nënshkruar në Romë, më 10 mars 1988. Protokollet e sugjeruara për aderim janë akte ndryshuese të konventës dhe protokollit të vitit 1988.

Qëllimi i dy protokolleve, në të cilat Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sugjeron të aderojmë, është amendimi i këtyre dy akteve të vitit 2001 dhe gjithashtu bërja palë në to është pjesë e angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë si anëtar i OKB-së.

Protokollet e konventave janë iniciuar në kuadër të legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me mbarëvajtjen e paqes dhe të sigurisë së lundrimit ndërkombëtar, duke promovuar siguri, marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare.

Aderimi në këto organizma synon të forcojë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, në aspektin e sigurisë detare, duke bashkëvepruar me organet kompetente.

Gjithashtu, është parë i nevojshëm aderimi në këto protokolle të konventave, duke iu referuar seriozitetit të organizatës dhe të shteteve anëtare, si edhe nevojës për të marrë masa të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, nëpërmjet rrugëve detare. Kjo realizohet me ndihmën dhe besimin e

ndërsjellë nga ana e pjesëmarrësve. Palët priren të realizojnë objektivat e tyre në lidhje me evidentimin e shkeljeve të rregullave të përcaktuara në protokollet e konventave dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKAKTIT NË RAPORT ME LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM, PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA

Aderimi i Republikës së Shqipërisë në këto protokolle të konventave kryhet në kuadër të përmbushjes së prioritetëve të qeverisë shqiptare në luftën kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit, akteve terroriste, të cilat synojnë të realizohen në rrugë detare. Duke pranuar se akte të tilla të kundërligjshme kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, nevojitet aderimi në këto konventa.

Projektakti është i parashikuar në planin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për vitin 2018, për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROTOKOLLEVE TË KONVENTAVE LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që priten nga aderimi i Republikës së Shqipërisë në protokolle lidhen me fushën e goditjes së krimit, akteve terroriste, sigurisë publike në rrugë detare, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit.

Palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër akteve të kundërligjshme detare, duke bërë të mundur goditjen e tyre, me qëllim ruajtjen e sigurisë detare. Pritet që palët, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje të konsultohen me njëra tjetrën në lidhje me problematikat që mund të lindin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Vlen të theksohet se aderimi në protokolle është iniciuar mbi bazën dhe nën frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Kuadri ligjor i brendshëm i është referuar edhe nenit 84, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ku parashikohet ‘bashkëpunimi ndërkombëtar’, dhe nenit 18, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Kuadri ligjor ndërkombëtar, në të cilin mbështeten këto konventa janë: Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, datë 18.4.1961; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Rezoluta 40/61 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e 9 dhjetorit 1985; Karta e Kombeve të Bashkuara e “OKB”; Rezoluta A.584 (14), e 20 nëntorit 1985, e Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare Detare; Rezolutat 1368 (2001), 1373 (2001) dhe 1540 (2004) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 51/210, të datës 17 dhjetor 1996, si dhe Deklarata e vitit 1994 mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar; Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit të kryer në Gjirin Montego, më 10 dhjetor 1982, dhe e drejta zakonore ndërkombëtare e detit; Protokolli i Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, bërë në Londër më 14 tetor 2005. Protokolli i Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse të vendosura në shefin kontinental, bërë në Londër më 14 tetor 2005L; Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, si dhe Kodi Ndërkombëtar i Sigurisë së Anijeve dhe Porteve (ISPS), të dyja të miratuara nga Konferenca e Qeverive Kontraktuese të vitit 2002, po në atë konventë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Aderimi i Republikës së Shqipërisë në këto protokolle nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË ADERIMIT TË PROTOKOLLEVE TË KONVENTAVE

Republika e Shqipërisë, nëpërmjet aderimit në këto protokolle, bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor detar. Këto protokolle kërkohet që të ratifikohen, për t’u bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Nëpërmjet aderimit në këto protokolle, vendi ynë merr përsipër të drejta dhe detyrime që lindin nga kuadri ndërkombëtar ligjor.

- Protokolli i vitit 2005 i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar.

Nenet 1 dhe 2 pasqyrojnë “Hyrjen” e konventës duke shtjelluar qëllimin e saj, shpjegimin e terminologjisë, strukturat përbërëse dhe bazën ligjore ku mbështetet.

Neni 3 (Rastet e konsumimit të veprës penale). Çdo person që kryen një veprë penale në mënyrë të paligjshme dhe me dashje konsiderohet shkelës i së drejtës së konventës. Në këtë nen pasqyrohen të gjitha shkeljet e veprave penale të mundshme.

Nenet 4 e 5 (Fushat e zbatimit). Kjo konventë zbatohet nëse anija po lundron në detin territorial të një shteti të vetëm ose kufijtë anësorë të detit të saj territorial me shtetet fqinje.

Nenet 6 e 7 (Juridiksioni mbi veprat penale). Secili shtet palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të përcaktuara në nenin 3 kur vepra penale është kryer sipas përcaktimeve të nenit 6.

Nenet 9 e 10 (Juridiksioni hetues). Asgjë në këtë konventë nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në rregullat e së drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me kompetencën e shteteve për të ushtruar juridiksion hetues ose përmbarimor në anijet që nuk fluturojnë në flamurin e tyre. Shteti palë në territorin e të cilit gjendet shkelësi ose autori i pretenduar, në rastet kur zbatohet neni 6, nëse nuk e ekstradon atë, është i detyruar, pa përjashtim, dhe nëse vepra është kryer në territorin e saj, të paraqesë rastin pa vonesë tek autoritetet e tij kompetente, me qëllim të ndjekjes penale, nëpërmjet procedurave në përputhje me ligjet e atij shteti. Këto autoritete marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e ndonjë shkeljeje tjetër të rëndë sipas ligjit të atij shteti. Çdo person për të cilin po zhvillohet procesi në lidhje me ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 3, do të garantohej trajtim i drejtë në të gjitha fazat e procedurës, duke përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive të parashikuara për këto procedura nga ligji i shtetit në territorin e të cilit ai është i pranishëm.

Neni 14 (Komunikimi i informacionit). Çdo shtet palë, që ka arsye të besojë se një shkelje e parashikuar në nenin 3 do të kryhet, në përputhje me ligjin e tij kombëtar, do të japë sa më shpejt të jetë e mundur çdo informacion përkatës në zotërim të tij ndaj atyre shteteve që beson se do të ishin shtetet që kanë themeluar juridiksionin, në pajtim me nenin 6.

Neni 16 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve). Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj konvente, e cila nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociimit brenda një kohe të arsyeshme, me kërkesën e njërit prej tyre, do të paraqitet në arbitrazh. Nëse, brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për arbitrim, palët nuk janë në gjendje të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, këto palë mund t'ia referojnë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë në përputhje me statutin e gjykatës.

Neni 17 rregullon nënshkrimin e konventës nga palët pjesëmarrëse.

Neni 18 normon hyrjen në fuqi të kësaj konvente.

Neni 19 parashikon dispozitat e denoncimit të aktit, nëse një shtet nuk dëshiron të jetë më pjesë e tij.

Neni 20 shpjegon si mund të kryhen ndryshimet në protokoll.

Neni 21 shpjegon si kryhen deklaratat mbi traktatet e renditura në shtojcë.

Neni 22 shpjegon se si do kryhen ndryshimet në shtojcë.

Neni 23 përcakton modalitetet e depozitimit mbi nënshkruesit dhe aderuesit.

Neni 24 përcakton gjuhët e nënshkrimit të protokollit.

- Protokollin e vitit 2005 për Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental

Neni 1 tregon emërtesat/shkurtesat e përdorura në protokoll.

Në nenin 2, neni 1, i paragrafit 1, i Protokollit të 1988, është zëvendësuar nga teksti me përmbajtje që shtjellon amendamentet ligjore të ndodhura.

Në nenin 3, neni 2, paragrafi 1(d), i Protokollit të 1988, është zëvendësuar nga teksti që pasqyron vendet dhe arsyet e vendosjes së platformës fikse. Gjithashtu, po në nenin 3, neni 2, paragrafi 1(e), i Protokollit të 1988, është zëvendësuar nga teksti me mundësinë e një kërcënimi të mundshëm që mund të rrezikojë sigurinë e platformës fikse nga persona subjekte të ndryshme.

Teksti i nenit 4 është futur te neni 2 dhe konsiston në rastet e kryerjes së një vepre penale kundrejt platformave fikse.

Në nenin 5, neni 3, paragrafi 1, i Protokollit të 1988, është zëvendësuar me tekstin ku pasqyrohet vendosja e çdo shteti palë e juridiksionit mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 2, nen 2bis dhe 2ter.

Neni 6 konsiston në interpretimin dhe zbatimin e Protokollit të vitit 1988, ku dhe ky Protokoll si ndërmjet palëve duhet të lexohet e të interpretohet si një instrument i vetëm. Nenet 1 deri 4 të këtij protokoll, janë rishikuar nga ky protokoll dhe bashkë me nenet 8 deri 13 të këtij protokoll duhet të caktohen dhe të quhen Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, 2005”(2005 SUA Fixed Platforms Protocol).

Neni 7 i tekstit është shtuar në nenin 4bis të protokollit, ku pasqyrohen klauzolat finale të Protokollit të Ndalimit të Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, 2005. Klauzolat finale të Protokollit të Ndalimit të Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosur në Shelfin Kontinental, 2005, duhet të jenë nenet 8 deri 13, të Protokollit të 2005, në Protokollin e Ndalimit të Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental.

Neni 8 tregon për klauzolat finale me përmbajtje si: “Firmosja, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi”.

Neni 9 konsiston tek hyrja në fuqi. Ky protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën tri shtetet e kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 10 parashikon denoncimin. Ky protokoll mund të denoncohet nga çdo shtet palë, në çdo kohë, pas datës që ky protokoll hyn në fuqi për atë shtet. Denoncimi kryhet me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 11 shtjellon rishikimin dhe ndryshimin. Një konferencë, me qëllim rishikimin ose ndryshimin e këtij protokollit, mund të organizohet nga organizata.

Nenet 12 e 13 përcaktojnë depozitarin dhe procedurën e depozitimit të instrumentit të aderimit, si dhe gjuhët e nënshkrimit të protokollit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për Republikën e Shqipërisë, autoritetet kompetente do të jenë ministrinë pjesëmarrëse në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Aderimi në këto konventa ngarkon me përgjegjësi për zbatim çdo palë nënshkruese të saj. Palët pjesëmarrëse marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga aderimi në këto konventa. Dy protokollat e konventave detare janë hartuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO), në bashkëpunim me organizma të tjerë ndërkombëtar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Aderimi në këto protokolle synon vendosjen e një pakete rregullash ndërkombëtare për trajtimin e krimeve në det dhe nuk ka kosto shtesë për Republikën e Shqipërisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE